VENDIM
Nr. 44, datë 27.1.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC), E DEPARTAMENTIT FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË ZVICRËS, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI, MBI PROGRAMIN "PROMOCIONI SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMI I SËMUNDJEVE KRONIKE NË SHKOLLA", FAZA PËRGATITORE, NJË PROJEKT BILATERAL BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Konfederatës së Zvicrës, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, mbi programin "Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve kronike në shkolla", faza përgatitore, një projekt bilateral bashkëpunimi dhe zhvillimi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC), E DEPARTAMENTIT FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË ZVICRËS, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI
MBI:
PROGRAMIN E PROMOVIMIT SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMIT TË SËMUNDJEVE KRONIKE NË SHKOLLA
Faza përgatitore
Një Projekt Bilateral Bashkëpunimi dhe Zhvillimi

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve,

Në zbatim të marrëveshjes kuadër në lidhje me Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmën Humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

Në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut – siç përcaktohet veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut – që frymëzojnë

politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbëjnë element thelbësor me mundësi të barabarta me objektivat e kësaj marrëveshjeje,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet

Kudo që përdoren në këtë marrëveshje, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Palë Kontraktuese" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverinë e Konfederatës Zvicerane;

b) "Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë" nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale dhe nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

c) "Konfederata Zvicerane" përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC) dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës;

d) "Projekt" nënkupton programin "Promovimi Shëndetësor dhe Parandalimi i Sëmundjeve Kronike në Shkolla";

e) "SDC" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës;

f) "Grant" nënkupton kontributin e dhënë nga Qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;

g) "Partner zbatues" nënkupton organizatën joqeveritare Save the Children Switzerland (Zvicër).

Neni 2
Autoritet përgjegjëse

1. Përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes do të jenë autoritetet e mëposhtme:

a) Për Konfederatën Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

b) Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. SDC-ja, si autoriteti përgjegjës i palës zvicerane, do t'i besojë zbatimin e projektit organizatës jofitimprurëse Save the Children Switzerland, si shoqëri fituese e tenderit me procedurë të hapur.

Neni 3
Qëllimet dhe objektivat

1. Marrëveshja do të ketë si qëllim zbatimin e fazës përgatitore të projektit.

Faza përgatitore ka objektiv kryesor përcaktimin e ndërhyrjeve në fazën kryesore të zbatimit të projektit.

2. Në fazën përgatitore të projektit synohet arritja e rezultateve kryesore si më poshtë:

- Një analizë e detajuar e situatës së *përfituesve* kryesorë të projektit (*alias*, audienca e synuar ose grupet e popullatës).
- Një analizë e detajuar e situatës së të gjitha *shkollave* dhe *institucioneve* kryesore (nga sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit dhe pushteti lokal) të përfshira në projekt, duke përfshirë vlerësimin e kushteve dhe situatës aktuale, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me aktivitetet dhe programet e promovimit shëndetësor me nxënësit e moshave shkollore.

- Bazuar në dy analizat e situatave të lartpërmendura, identifikimin e qasjes më të përshtatshme ndërhyrëse (dokumentit të projektit) dhe një modeli të zbatueshëm në kontekstin shqiptar, i cili do të nxisë ndryshimin e sjelljeve pozitive te nxënësit e shkollave, duke promovuar modele të shëndetshme të sjelljes dhe praktikave të shëndetshme të mënyrës së jetesës.

3. Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje, autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë me sektorin publik dhe privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

Institutin e Shëndetit Publik, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe entet e tij rajonale, Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Drejtorinë e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe grupet e interesit.

Neni 4

Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Konfederata Zvicerane, si palë kontraktuese, e përfaqësuar sipas parashikimeve më lart, në zbatim të kësaj marrëveshjeje:

a) Angazhon, deri më datë 28 shkurt 2021, fonde në formë të një granti të parimbursueshëm ekuivalent me një shumë maksimale prej CHF 666'700 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) franga zvicerane, që do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar në nenin 3;

b) Ky grant nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përmbushjes së projektit. Çdo pjesë e pashfrytëzuar e grantit, që mbetet në fund të projektit është objekt i rifinancimit të Konfederatës Zvicerane;

d) Granti do të disbursohet dhe auditohet sipas dispozitave të kontratës ndërmjet SDC-së dhe partnerit zbatues.

2. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar sipas parashikimeve më lart:

a) vendos se do të veprojnë si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e projektit dhe si bashkëdrejtuese në mbledhjet e Komitetit Drejtues Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

b) siguron lidhjen e projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin ligjor përkatës për prioritetet në sektorin e shëndetësisë, në mënyrë që të mundësojë dhe promovojë koherencën e objektivave të projektit me kushtet e kuadrit kombëtar;

c) mbështet lehtësimin dhe shpërndarjen e përvojave dhe informacionit bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e projektit në nivel kombëtar;

d) përkrah dhe lehtëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera;

e) siguron reagimin dhe bashkëpunimin e strukturave të varësisë në nivel rajonal dhe /ose lokal;

f) mbështet dhe ndihmon në zbatimin e aktiviteteve hulumtuese;

g) vë në dispozicion alokimin e nevojshëm të buxhetit për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në lidhje me fazën përgatitore të projektit për një shumë maksimale prej CHF 80'000 (tetëdhjetë mijë franga zvicerane). Buxheti i nevojshëm për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) do të vendoset në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

h) Këshilli i Ministrave u jep ekspertëve të huaj të angazhuar sipas kësaj marrëveshjeje dhe familjeve të tyre një përjashtim të të gjitha taksave gjatë vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 4.1, pika "b", të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Teknik-Financiar dhe Ndihmën Humanitare.

Neni 5
Menaxhimi i Projektit

a) Projekti është një ndërmarrje e përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe SDC-së nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës;

b) Konfederata Zvicerane ka mandatuar Save the Children Switzerland si agjenci zbatuese për projektin. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër të gjitha detyrat operative, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC-ja mund të mandatojë ekspertë të huaj dhe lokalë afatgjatë dhe afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e projektit në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bazuar në planin vjetor të aktiviteteve të miratuar nga komiteti drejtues i projektit;

d) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve që do të dakordësohen në kuadër të zbatimit të projektit; bashkëdrejtojnë mbledhjet e Komitetit Drejtues; sigurojnë akses në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhënat statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e Projektit.

Neni 6
Mbikëqyrja dhe bashkërendimi

1. Për të siguruar mbikëqyrjen e përgjithshme, cilësinë, rëndësinë dhe bashkërendimin e projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të funksionojë Komiteti Drejtues, i cili do të mblidhet të paktën dy herë në vit (normalisht në muajin prill dhe tetor).

2. Komiteti Drejtues do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë me të drejtë për të vendosur dhe 5 (pesë) anëtarë me status vëzhguesi dhe do të bashkëkryesohet nga palët kontraktuese, si më poshtë:

a) Anëtar me të drejtë për të vendosur:

1 përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Shqipërisë (bashkëkryetar);
1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (bashkëkryetar);
1 përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (bashkëkryetar);
1 përfaqësues i Institutit të Shëndetit Publik;
1 përfaqësues i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
1 përfaqësues i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;
1 përfaqësues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

b) Anëtar me status vëzhguesi;

1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shëndeti publik/Kujdesi Parësor;
1 përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
1 përfaqësues i Departamentit të Shëndetit Publik;
1 përfaqësues i UNFPA-së/UNICEF-it;
1 përfaqësues i FAO-s.

Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, grupe të tjera interesi mund të ftohen të marrin pjesë në rolin e vëzhguesit.

Sekretariati i Komitetit Drejtues ofrohet nga partneri zbatues. Drejtuesi i ekipit të projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

3. Komiteti Drejtues do të arrijë kuorum vetëm kur të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët me të drejtë për të vendosur. Vendimet merren me unanimitet të të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë për të vendosur. Nëse nuk mund të arrihet unanimiteti, do të fillojnë një proces negocimi. SDC-ja, si autoritet përgjegjës përfaqësues i palës Zvicerane rezervon të

drejtën e vendimit përfundimtar në rast se nuk arrihet konsensus në përfundim të procesit të negocimit.

Komiteti Drejtues do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Rishikimi dhe diskutimi i progresit në lidhje me të gjitha aspektet e promovimit shëndetësor (p.sh. qasja ndërsektoriale mbi promovimin e shëndetit, promovimi i shëndetit në shkolla, kapacitetet e mësuesve, ndryshimet në kurrikula, mekanizmat financues të promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve kronike etj.);

b) Shqyrton dhe miraton raporte gjashtëmujore dhe vjetore të progresit të projektit, duke përfshirë statusin e shpenzimeve ndaj buxhetit;

c) Jep komente dhe miraton Planin Vjetor të Aktiviteteve të dorëzuara në SDC;

d) Monitoron ecurinë e zbatimit të projektit kundrejt objektivave/treguesve dhe planeve vjetore të punës;

e) Udhëzon aktivitetet kërkimore dhe të monitorim/vlerësimit gjatë zbatimit të projektit;

f) Ofron udhëzime për Projektin për përafrimin e veprimtarive të detajuara vjetore në përputhje me prioritetet kombëtare;

g) Kërkon asistencë teknike të specializuar të harmonizuar në fushat kyçe, kur është e nevojshme;

h) Identifikon, diskuton dhe propozon zgjidhje për problemet e mundshme të reformës shëndetësore në Shqipëri dhe masat e nevojshme.

Takimi i paplanifikuar mund të kërkohet me kërkesë të një prej anëtarëve të Komitetit Drejtues. Takimet bashkëkryesohen nga palët kontraktuese.

Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra tjetrën dhe në masën e arsyeshme praktike, do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo rast që ndërhyn ose rrezikon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7

Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga të ardhurat e kontributit zviceran, do të prokurohen nga Save the Children Switzerland në përputhje me pragun/kufirin e caktuar në zbatim të ligjit zviceran për prokurimin publik.

b) Për kohëzgjatjen e Projektit, mallrat e siguruara me fonde të SDC-së për përdorim në Projekt do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SDC-së;

c) Nëse për çfarëdo arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara me kontributin zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët;

d) Në fund të projektit, SDC-ja do të vendosë mbi pronën dhe përdorimin e mallrave të prokuruara gjatë kohës së zbatimit të Projektit;

e) Mallrat e prokuruara nga Projekti për organizatat partnere duhet të dorëzohen dhe të merren nga autoritetet përgjegjëse me miratimin e SDC-së.

Neni 8

Pezullimi dhe përfundimi i marrëveshjes

a) Secila Palë do të ketë të drejtën ta ndërpresë këtë marrëveshje, duke dhënë njoftim me shkrim gjashtë muaj para përfundimit të saj.

b) Nëse secila Palë çmon se qëllimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të arrihen ose se Pala e dytë nuk i përmbush detyrimet e saj, pala tjetër do të ketë të drejtë të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje duke dhënë njoftim me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga çfarë është parashikuar më parë, secila Palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje me efekt të menjëhershëm në rast të shkeljes së konsiderueshme të marrëveshjes. Shkelja e konsiderueshme nënkupton shkelje serioze të një prej objektivave thelbësorë të kësaj marrëveshjeje.

c) Pezullimi dhe mundësia e rihyrjes në fuqi do t'i njoftohet menjëherë Palës tjetër në rrugë diplomatike dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së informacionit nga Pala tjetër.

d) Nëse rastet që rezultojnë nga forca madhore pengojnë ekzekutimin e marrëveshjes, secila Palë mund ta ndërpresë marrëveshjen me efekt nga momenti kur bëhet e pamundur për ta zbatuar atë.

e) Në rast të ndërprerjes së parakohshme të kësaj marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i siguruar në kuadër të Projektit, do t'i kthehet SDC-së.

Neni 9

Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet negociatave në rrugë diplomatike ndërmjet Palëve.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, Palët nuk do të propozojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as të tërthortë, përfitime të asnjë lloj natyre. Ato nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme nënkupton shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon ndërprerjen e saj, si dhe/ose alternativën ndaj masave plotësuese korrigjuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje mbulon periudhën deri më 28 shkurt 2021. Ajo do të hyjë në fuqi me njoftimin e fundit mes palëve për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

Kjo marrëveshje është hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet e teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast të mospërputhjeve të interpretimit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Palët, me anë të kësaj marrëveshjeje, konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje të lidhur në Tiranë, më ....

Në emër të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane:	Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:	
Adrian Maître	**Ogerta Manastirliu**	**Evis Kushi**
AMBASADOR	MINISTËR	MINISTËR
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë